ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER
LEKARSKA KOMORA KOSOVA
Njësia: Unit: Jedinica: KEVP
Nr. I faqeve: No. of pages: Br. stranica: -2-
Nr. Prot.: Prot. No.: Br. Prot.: 155
Data: Date: Datum: 19.09.2019
Prishtinë/a
KEVP - KL

ETHICE • DOCTRINA • OMK • IUSTITIA

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

PËR: Dr. Basri Sejdiu, Drejtor i Përgjithshëm SHSKUK
Drejtorët e Klinikave, Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Drejtorët e Spitaleve Rajonale
Drejtorët e Qendrave Kryesore të Mjekësive Familjare
Drejtorët e Qendrave të Mjekësisë Familjare
Drejtorët Komunal të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Drejtorët e Institucioneve Private Shëndetësore

NGA: Prof. Ass. Dr. Shemsedin Sadiku- Kryetar i Komisionit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, Oda e Mjekëve të Kosovës

LËNDA: Qarkore informative për afatin e fundit për akreditimin e planeve vjetore të edukimit të vazhdueshëm profesional për vitin kalendarik 2020

DATË: 19.09.2019

Të nderuar udhëheqës të institucioneve shëndetësore,

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional i OMK-së në mënyrë ekskluzive zbaton kompetencën publike të mbikqyrjes dhe aranzhimit të edukimit të vazhdueshëm profesional të mjekëve. Me ushtrimin e këtij funksioni publik, Komisioni bartë përgjegjësinë e menaxhimit dhe akreditimit të aktiviteteve të EVP-se.

Andaj, në cilësi të Kryetarit të Komisionit Ju njoftoj se duhet të iniconi procedurën për akreditim të planit vjetor të ligjeratave për vitin 2020. Ju lutem të angazhoni koordinatorët për EVP pranë institucioneve që ju udhëhiqni, për të plotësuar aplikacionin e bashkangjitur për akreditim të ligjeratave vjetore. Ky aplikacion duhet të dorëzohet jo më vonë se data 15 nëntor 2019 i cili është afati i fundit për akreditim të planit vjetor të edukimit të vazhdueshëm profesional për vitin 2020.

Ju rikujtoj se vitin e kaluar ky afat është shtyrë për shkak se ka qenë viti i parë i ushtrimit të këtyre kompetencave nga OMK dhe si rrjedhojë jo të gjitha institucionet shëndetësore kanë pasur informatën për afatin e lartëshënuar, mirëpo këtë vit ky afat do të jetë përfundimtar dhe asnjë aplikacion pas kësaj date nuk do të pranohet.

Gjithshtu, Ju informoj se çdo ndryshim eventual i programit vjetor psh. datat e mbajtjes së ligjëratave, ndryshimi/shtuarja/heqja e ligjëruesve të deklaruar fillimisht, Komisioni për EVP duhet të njoftohet me shkrim së paku 15 ditë përpara se të krijohen efektet nga ndryshimi (përjashtim nga ky afat do të kenë vetëm ndryshimet në rast të pjesëmarrjes së ligjeruesve ndërkombëtar të thirrur). Mos-përmbajtja e përshkrimeve të planit vjetor të akredituar do të rezultoj me revokimin e certifikatës për akreditim dhe aktivitetet e mbetura do të konsiderohen si të paakredituara.

Të bashkangjitura gjeni aplikacionin për akreditim të planit vjetor i cili duhet të plotësohet në detaje si dhe listën me të cilën duhet të mbani evidencën e vijueshmërisë në ligjërata. Evidenca duhet të mbahet me lista të veçanta për mjekët në të cilën nuk duhet të përfshihen profesionistët tjerë shëndetësor.

Me respekt,
Kryetari i Komisionit për EVP
Prof.Ass.Dr. Shemsedin Sadiku

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS • KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA • 2013 •